



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1144/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ranko Kostiqit anetar i subjektit politik Socialdemokracia dega ne Kline, paraqitur kunder Komesariatit per personat e zhvendosur pas publikimit te rezultateve perfundimtare nga KQZ-ja per kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit te votave , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ranko Kostiqit koordinator i subjektit politik Socialdemokracia dega ne Kline.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Ranko Kostiq anetar i subjektit politik Socialdemokracia dega ne Kline te cilet pretendojne se jane demtuar gjate numrimit te votave ne qytetet e Serbise si ne Kraleve, Velika Plana, Kragujevc, Pozhegë, Beograd dhe ne vende te tjera duke qene te sigurt dhe te bindur ne votusit tone votat e te cileve jane zavendsuar duke ia bartur subjektit politik GIS nga disa njerëz ne komesariatit e lartepemendur te cilet kane bere numrimine votave ne keto vendvotime andaj kerkojme shqyrtimin e kredibilitetit te votimit sepse mendojme se jemi fitus te bindshem. Si fakte shtese jane edhe votimet e dyfishta te disa qytetatreve si ne Serbi edhe ne Kosove, duke cituar personat si Sharkovic Stanisha, Sharkovic Stosha, Sharkovic Novica, dhe Sharkovic Dushan te cilet kane votuar edhe ne Kraleve edhe ne Kline ne vendvotimin nr 0819C fshati Vidanje. Keshtu qe ne baze te ketyre manipulimeve te votave dhe parregullsive gjate precesit zgjedhor kerkojme qe te anulohen rezultatet e votimit jashte Kosoves per komunën e Klina edhe kunder personave te lartepemendur te inicohet procedur penale te institucinet kompetente per keqpedorimin e te drejtes per te votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmitet e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit zgjedhor , vlerësohen si te pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1144/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*